



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM  
Nr. 76, datë 20.02.2020

PËR  
NDRYSHIMIN E PJESSHËM DHE KORRIGJIMIN E GABIMIT NË SHKRIM TË  
VENDIMIT NR. 30, DATË 21.01.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR,  
“PËR CAKTIM GJYQTARI, NË NJË ÇËSHTJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË  
GJYKATËN E APELIT GJIROKASTËR”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 112, 113 dhe 117, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në pikën 3, të nenit 97 dhe nenin 99, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me Kërkesë nr.102 prot., datë 30.01.2020, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, pasi konstatoi gabimin në shkrim sa i përket mbiemrit të të pandehurit, në paragrafin I, nënndarja “Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pika 5, të Vendimit të tij nr.30, datë 21.01.2020, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”, si dhe në kushtet kur gjatë procedurave të shortit për caktimin e gjyqtarit në këtë rast nuk është mbajtur parasysh së gjyqtari i përzgjedhur nga shorti, z. {...}, ka qenë i caktuar më herët për gjykimin kësaj çështjeje pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, mbas përsëritjes së procedurës së shortit,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e pjesshëm dhe korrigjimin e gabimit në shkrim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 21.01.2020, “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pika 5, si më poshtë:

*“5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}, etj; Akuzat: “Mashttrim kryer në bashkëpunim”.*

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**